



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2020:062253

Datë: 03.07.2020

Numri i dokumentit: 01005244

**P.nr.120/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PEJE –DEGA I. – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-Divizioni Penal**, sipas gjyqtarit të vetëm gjykues Arben Mustafaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Hale Ahmetaj, në lëndën penale kundër të pandehurit A. V. nga f.sh. L. i B. K. I. , i akuzuar për vepër penale, “lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.1,nën par.1.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.372/2020, dt. 01.04.2020, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me **01.07.2020** në praninë e Prokurorit të Shtetit, Suada Hamza, të pandehurin A. V., Gjykata të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 03.07.2020 e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri **A. V.** , i lindur me ..... ne I. , tani me banim ne f.sh. L. i B. rr. “Q.” nr..., K. I. , i biri i B. dhe nenës K. e gjinisë Z., i martuar baba i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion taksist, i gjendjes se dobët ekonomike, i identifikuar ne bazë të letërnjoftimit me nr..., Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës, i a dënuar me parë nga Gjykata, gjendet ne liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se :**

Me date ..., rreth orës .... ne fshatin D., K I. , pranë varrezave te fshatit, tjetrit i shkakton lëndime te lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndet dhe atë të dëmtuarit B. A. , ne atë mënyrë që ditën kritike derisa i dëmtuari ishte me ekskavator duke e hapur një kanal për ujitje te tokës ne afërsi te varrezave te fshatit dhe me te vërejtur këtë i pandehuri Azllan i ofrohet dhe fillojnë një përleshje verbale, pasi kanali po hapej ne afërsi te pronës se të pandehurit dhe pa lejen e tij ku me pas i pandehuri i revoltuar fillimisht e shtynë dhe pastaj e godet te dëmtuarin nga pas, si pasoje e goditjeve i dëmtuari pëson lëndime te lehta trupore me pasoja te përkohshme për shëndet,

-me çka ka kryer veprën penale, “Lëndim i lehte trupor” nga neni 185 par. 1 ,nen par.1.4 te KPRK-se.

Gjykata duke vendosur në kuptim të nenit 7,8,9,10,17,21,38,40,43,69,70, nenit 185 par. 1 ,nen par.1.4 te KPRK-se, si dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366, 450, 463 të KPPRK-së, i shqipton:

**DËNIM ME GJOBË**

### **Ashtu që:**

**1.**Të pandehurit **A. V.**, gjykata i përcakton dënimin me gjobë në shumën prej **200 (dyqind) euro**, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**2.** Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguan gjobën e lartë shqiptuar me kohë të përcaktuar, e njëjta gjobë do të zëvendësohet me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ku (njëzete)20 euro të gjobës, do të llogariten në një ditë burgim.

**3.** I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20 (njëzet) euro**, në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumën prej **20 (njëzet) euro**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të kimit shumë prej **30 (tredhjet) euro** në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**4.** I dëmtuari **B. (R.) A.** nga fsh. D. K. I., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë– Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj Gjykate ka ngritë aktakuzën PP/II.nr.372/2020, dt. 01.04.2020, ndaj të pandehurit A. V. nga f.sh. L. i B. K. I., duke e akuzuar për veprën penale, “lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.1,nën par.1.4 të KPRK-së .

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.01.07.2020 në praninë e Prokurores së Shtetit Suada Hamza, dhe të pandehurit A. V., ndërsa duke vepruar në kuptim të nenit 245 të KPRK-së, në seancën fillestare nuk i ka ftuar palët tjera.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, me vjen keq për rastin që me ka ndodhur, është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin i kërkoj falje publike para gjykatës të dëmtuarit me të cilin gjithmonë kemi pasur raporte të mira, jemi fqinje në mes veti, tani pas këtij rasti kemi ndejt së bashku jemi përshëndetur, nuk ka qenë qëllimi im që të shkaktoj lëndime trupore, mirëpo ai fillimisht me ka kapur në gjokse dhe unë pasi e kam shtyre atë nga vetja, ai është rrezuar dhe ka rënë me koke në një mur, të cilit pastaj ka filluar të i rrjedh gjake nga koka, unë pastaj ia kom ofruar ndihmën duke e kapur për ta ngritur në këmbë, ku djali i tij e ka dërguar tek mjeku, ju premtoj se në të ardhmen nuk do të bije ndesh me ligjin dhe do shkoj në shtëpinë e tij për të kërkuar falje.

Gjykata mori mendimin e Prokurorit i cili deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë, i cili pranim ka mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe është bere komfor dispozitive ligjore, propozoj gjykatës që të pandehurin të shpall fajtor për veprën e kryer dhe të dënoj sipas ligjit, dhe të obligoj në pagesën e shpenzimeve procedurale, si dhe me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim pranimin e fajësisë ta marr si rrethanë lehtësuese tërë matja e dënimit.

Pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet dhe mendimit të prokurorit të shtetit, se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se

i pandehuri pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata me aktvendim në procesverbal aprovon deklarinimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 248 par.1 lidhur me par.4 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje penale pas aktvendimit mbi pranimin e fajësisë, gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, si dhe me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit A. V. , është vërtetuar se i njëjti me date ....., rreth orës ... në fshatin D., K I. , pranë varrezave të fshatit, tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndet dhe atë të dëmtuarit B. A. , në atë mënyrë që ditën kritike derisa i dëmtuari ishte me ekskavator duke hapur një kanal për ujtime të tokës në afërsi të varrezave të fshatit dhe me të vërejtur këtë i pandehuri A. i ofrohet dhe fillojnë një përleshje verbale, pasi kanali po hapej në afërsi të pronës së të pandehurit dhe pa lejen e tij ku me pas i pandehuri i revoltuar fillimisht e shtynë dhe pastaj e godet të dëmtuarin nga pas, si pasojë e goditjeve i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndet,

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedhë se në veprimet e të pandehurit A. V. , qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale "lëndim i lehtë trupor" nga neni 185 par.1, nën par.1.4 të KPRK-së .

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i pandehuri ka kryer veprën me dashje, pasi që ai ka qenë i vetëdijshëm për veprën penale dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës për veprën penale që i vihet në barrë.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti kishte sjellje korrekte në Gjykatë, e për më tepër e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet, duke kërkuar falje dhe pendesë për veprën e kryer, i pandehuri ka deklaruar se me të dëmtuarin janë fqinje dhe raportet në mes veti i kanë ë mira, është hera e parë që bije ndesh me ligjin, të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të të pandehurit. Rrethanë rënduese gjykata pasojën e shkaktuar të dëmtuarit të cilit i janë shkaktuar lëndime të lehta trupore sipas akt-ekspertimit mjeko-ligjorë të punuar për këtë rast.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale dhe paushallin gjyqësor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par.3 nën par 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Gjykata e ka udhëzuar të dëmtuarën në kontest të rregullt juridiko-civil, në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA I.  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr. 120/20, më datë 01.07.2020**

**Sekretarja Juridike**

**Hale Ahmetaj**

**Gjyqtari Gjykues**

**Arben Mustafaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.